

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Tetor, 2021**

Edhe një dëshmi për përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të arsimit
**Në takim me Ministren Nagavci u kërkuar normalizimi
 i procesit mësimor**



Në takimet e shumta me kolegët tanë sindikalistë kudo në Kosovë është debatuar për çështje sindikale, por edhe për gjendjen momentale në sektorin e arsimit. Nga këto bashkëbiseda doli qëndrim i përbashkët se pas një qetësimi të dukshëm të situatës me pandeminë është koha që të normalizohet në tërësi procesi mësimor në Arsimin Parauniversitar. Një kërkesë të tillë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për ...(faqe 4)

ETUCE vazhdon takimet me
 sindikatat anëtare

**Në përballje me sfidat e
 shumta të kohës**

Komiteti i Sindikatave të
 Arsimit të Evropës ka mbajtur
 komunikim të vazhdueshëm
 me sindikatat anëtare që
 përfaqësojnë 11 milionë
 punëtorë të arsimit nga gjithë
 shtetet e Evropës ...(faqe 10)

*Bisedë me kryetarin e ri të
 BSPK-së, prof.dr. Atdhe
 Hykolli*



Jam krenar me besimin që
 mora nga të gjitha
 Federatat sindikale (faqe 3)

Vazhdon të realizohet agenda e Kuvendeve zgjedhore

**Respekt dhe përkrahje për SBASHK-un kudo në
 Komunitet e Kosovës**



Krahas aktiviteteve tjera, stafi qendror ka shtuar ...(faqe 6)

Është rikthyer aktiviteti i trajnimeve nga SBASHK

**Trajnime në Deçan, Kamenicë dhe dy trajnime me
 kolegët nga komuna të tjera**



SBASHK-u kishte mobilizuar gjithë ...(faqe 4)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
 The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Dy festat krenare të mësuesit



Një numër i madh i mësuesve të botës kanë dy festa krenare. Njëra është kombëtare, kurse tjetra është në çdo 5 tetor, kur shënohet dita botërore e mësuesve. Kështu është edhe me mësuesin shqiptar të Kosovës. Ai me krenari e përmes manifestimeve të SBASHK-ut shënon 7 Marsin duke lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes nëpër shekuj e dekada, por edhe në çdo 5 tetor i bashkohet të 31 milionë kolegëve nga e tërë bota dhe me aktivitete të shumta shënojnë këtë datë me rëndësi.

Pandemia që kaploi tërë botën ka bërë që edhe aktivitetet festive për këto dy data të pësojnë ndryshime dhe të mos ketë Manifestime me pjesëmarrje të madhe të mysafirëve e mësuesve, por as SBASHK e as Internacionalja e Arsimit e Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës nuk heshtën. I shënuan këto data me aktivitete

më modeste, por shumë domethënëse duke kujtuar e shprehur respekt meritore për gjithë mësuesit që mbrojtën dritën kundër errësirës dhe hapen shtigje drejt njohurive të reja në kushte tepër të vështirësuar, që sillnin sfidat e kohës. Këtë ditë u lartësua kujtimi për gjithë kolegët tanë kudo në botë që kanë humbur betejën me Covidin. "Së bashku ne nderojmë mësuesit që kemi humbur gjatë pandemisë COVID, kujtojmë jetën dhe trashëgiminë e tyre, dhe rekomandojmë që kushtet e sigurta të punës dhe barazia e vaksinave të bëhen realitet për të gjithë globin." – u është drejtuar sindikatave anëtare Sekretari i përgjithshëm i Internacionales së Arsimit David Edvards.

Këto data janë festa krenare të mësuesit dhe së paku në këto dy ditë e në çdo vit edhe institucionet në Kosovë, Evropë e botë kthejnë shikimin nga mësuesi e shkolla dhe flasin me respekt për pishtarët dhe foletë e dijes. Bota do të triumfojë mbi pandeminë dhe jeta do t'i kthehet normalitetit dhe pastaj mësuesit në Kosovë do t'i festojnë me aktivitete e Manifestime madhështore të dy këto festa krenare.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38/ 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e ri të BSPK-së, prof.dr.Atdhe Hykolli

Jam krenar me besimin që mora nga të gjitha Federatat sindikale



Më 2 tetor në ambientet e Fakultetit të edukimit u mbajt Kongresi i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Delegatët nga të gjitha Federatat, që janë anëtare të BSPK-së me votën e lirë e të fshehtë kanë zgjedhur për kryetar të ri të kësaj Konfederate prof. dr. Atdhe Hykollin, i cili në mandatin e kaluar ishte nënkryetar. Me të marrë të detyrës kryetari Hykolli ka nisur me angazhimet dhe me takimet me përfaqësues të Federatave duke bashkëbiseduar me ato e duke marrë edhe ide për angazhimet e radhës. Në bisedë për gazetën tonë kryetari Hykolli flet për momentet e para të angazhimeve në këtë detyrë dhe për objektivat që ai ka e që synon t'i realizojë i përkrahur nga kryetarët e Federatave, nga Kryesia ekzekutive, por edhe nga gjithë anëtarësia kudo në Kosovë.

Ai tregon se ka mbajtur edhe takimin e parë me Kryesinë Ekzekutive për ta konsistuar këtë organ tepër të rëndësishëm bazuar në Statutin e BSPK-së dhe se ky takim dhe përkrahja e hapur që i kanë dhënë gjithë anëtarët e kryesisë i kanë dhënë elan e motiv shtesë për angazhimet dhe i kanë forcuar bindjen se të bashkuar e duke u gjetur në të njëjtin front të angazhimeve në shërbim të anëtarësisë nuk do të mungojnë arritjet, edhe pse koha është me plot sfida. Hykolli tregon se nga angazhimet e para për të cilat duhet forcuar zëri sindikal dhe duhet insistuar zgjidhje të duhur nga Qeveria dhe institucionet është dialogu i mirëfilltë social, paga minimale, Ligi i pagave, Ligji për sigurimet shëndetësore, Marrëveshja Kolektive dhe çështje të tjera që janë ngritur nga Federatat anëtare.

Kryetari Hykolli ka shtuar angazhimet që në takimet me Federatat të forcohet uniteti te to sepse unik e të bashkuar do të kemi një zë edhe më i fuqishëm sindikal dhe do ta kemi edhe solidaritetin e shtuar mes Federatave, të cilat do ta përkrahin e mbështesin njëra-tjetrën në momentet e kërkuara dhe kështu të gjithë do të dalin faqebardhë në përballje me sfidat, që nuk janë të pakta se sa vijnë e shtohen.

Kryetari Hykolli falënderon të gjitha mediet në Kosovë që po i japin hapësirë meritore angazhimeve të tashme të BSPK-së dhe premton se do të jetë gjithmonë korrekt me to duke u ofruar gjithë informacionet e duhura për angazhimet, shqetësimet dhe veprimet që do të ndërmarr BSPK-ja në përpjekje për të realizuar dialog të frytshëm me institucionet me qëllim të realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë. Hykolli është i bindur se të punësuarit në sektorin publik, po edhe ata në sektorin privat, që deri tani kanë hezitur të jenë sindikalistë do t'i bashkohen radhëve të BSPK-së sepse aty do ta gjejnë mbrojtësin e vërtetë të të drejtave të tyre dhe realizuesin e kërkesave legjitime.

Gjatë muajit

Edhe një dëshmi për përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të arsimit

Në takim me Ministren Nagavci u kërkuar normalizimi i procesit mësimor

Në takimet e shumta me kolegët tanë sindikalistë kudo në Kosovë është debatuar për çështje sindikale, por edhe për gjendjen momentale në sektorin e arsimit. Nga këto bashkëbiseda doli qëndrim i përbashkët se pas një qetësimi të dukshëm të situatës me pandeminë është koha që të normalizohet në tërësi procesi mësimor në Arsimin Parauniversitar. Një kërkesë të tillë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri i kanë prezantuar Ministres së MASHTI-t duke përmendur faktin se situata me pandeminë është përmirësuar dukshëm dhe se janë krijuar kushtet që arsimit në Kosovë t'i kthehet në tërësi normaliteti duke nënkuptuar që paralelet e ndara në grupe të bashkohen prapë dhe orët mësimore të jenë në kohëzgjatjen e duhur. Këtë vlerësim të anëtarësisë përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë përforcuar me faktin se edhe Shqipëria, Maqedonia e Veriut e shtete të tjera e kanë normalizuar në tërësi procesin mësimor.

Ministrja e MASHTI-t Arbërie Nagavci ka përgëzuar SBASHK-un për bashkëpunimin korrekt

dhe për angazhimet në shërbim të arsimit duke u shprehur se përkrah kërkesën për normalizim të plotë të arsimit dhe se për këtë do të bashkëbisedojë edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet të tjera me shpresën se ky propozim do të shqyrtohet me qëllim që në kohën më të shkurtër të mundshme të merret vendimi për normalizimin e plotë të procesit mësimor me zotimin e të gjitha palët të vazhdojnë me angazhimin, kujdesin dhe përkushtimin për ruajtjen e gjendjes së qetë e të favorshme në institucionet arsimore. Do theksuar se kështu edhe ndodhi ngase institucionet vendosen për kthimin e normalitetit të plotë në procesin mësimor në tërë Kosovën.



Është rikthyer aktiviteti i trajnimeve nga SBASHK

Trajnime në Deçan, Kamenicë dhe dy trajnime me kolegët nga komuna të tjera



SBASHK-u kishte mobilizuar gjithë kapacitetet për të dhënë kontribut në fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor, pas dy shtyrjeve për arsye të gjendjes së rëndë me pandeminë, që ishte prezentë për një kohë në tërë Kosovën. Pas fillimit të mbarë SBASHK-u vazhdoi me angazhimet e përkushtimin që procesi mësimor t'i kthehet normalitetit të plotë dhe edhe kjo u arrit. Pas kësaj stafi qendror i SBASHK-ut po vazhdon me aktivitetet në shërbim të anëtarësisë dhe

njëri nga to është edhe organizimi i trajnimeve të licencuara.

Ky aktivitet është rikthyer në vikendin e kaluar me dy trajnime me prani fizike dhe me dy online për të vazhduar me grupe të tjera për të cilat stafi qendror po bën gjithë përgatitjet në koordinim me kryetarët e nivelit komunal sindikal.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës


Të shtunën e 30 tetorit trajnerja Xhevrije Sabedinaj ka nisur me trajnimin “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e punës së rrezikshme” me koleget e kolegët tanë në Komunën e Kamenicës. Ky trajnim zhvillohet me prani fizike dhe ka vazhduar edhe të dielën e 31 tetorit. I njëjti trajnim udhëhequr nga trajnerja Drita Kamberi ka filluar po të shtunën me koleget dhe kolegët në Deçan dhe ka vazhduar edhe të dielën. Trajneret Sabedinaj dhe Kamberi do të vazhdojnë këtë aktivitet në marrëveshje me pjesëmarrësit për të arritur në tërësi objektivat e parashtruara.



Po të shtunën e 30 tetorit kanë filluar edhe trajnimet përmes platformës gjegjëse “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore” me trajneren Arberina Hajzeri dhe trajnimi me kolegët e komunitetit turk “Edukimi dhe Menaxhimi

Mjedisor ne Arsimin Parauniversitar, i udhëhequr nga trajnerja Esyngyl Dinovci.

Të dielën kryetari i SBASHK-ut është kyçur dhe i ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i falënderuar për angazhimin dhe për unitetin e treguar në SBASHK. Pjesëmarrësit kanë falënderuar kryetarin Jasharaj për këtë bashkëbisedë duke shprehur respekt për angazhimin e tij dhe stafit qendror në realizimin e kërkesave legjitime të gjithë anëtarësisë.



SBASHK në Kongresin e Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë së Veriut Takime me mikpritësit dhe me delegacionet e shumë sindikatave



kudo në këto shtete. Kështu përfaqësues të SBASHK-ut duke iu përgjigjur ftesës së kolegëve të tyre nga

SBASHK ka marrëdhënie të mira me shumicën e sindikatave të arsimit të shteteve të Ballkanit dhe ky bashkëpunim shprehet edhe me takimet, por edhe me pjesëmarrjet në ngjarjet e veçanta që organizohen

Maqedonia e Veriut kanë marrë pjesë në punimet e Kongresit të Sindikatës së Arsimit Kulturës e Shkencës së këtij shteti. Në kuadër të këtij aktiviteti kryetari SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri fillimisht kanë zhvilluar një takim përmbajtësor me të parin e Sindikatës së Arsimit Jakim Nedelkov dhe me anëtarë të kryesisë së kësaj sindikate duke vlerësuar lartë bashkëpunimin mes dy këtyre sindikatave.

Po ashtu përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë zhvilluar takime dhe kanë diskutuar për vazhdimin e bashkëpunimit edhe me përfaqësues të sindikatave



tjera, që ishin mysafirë të Kongresit në Maqedoninë e Veriut. Kjo ngjarje e veçantë për arsimin e Maqedonisë së Veriut u mbajt në ambientet e Teatrit Kombëtar dhe fillimisht mikpritësi kishte përgatitur një program të pasur artistik në shenjë respekti për mysafirët dhe pjesëmarrësit tjerë. Pas pjesës solemne mysafirët janë shoqëruar në një vizitë pjesëve të ndryshme të Shkupit, kurse Kongresi ka vazhduar me punimet.



Delegatët e votën e fshehtë duke shprehur respektin për gjithë angazhimet dhe arritjet e kanë rizgjedhur

edhe për një mandat kryetarin Jakim Nedelkov, i cili pastaj në një takim solemn u ka premtuar sindikatave mysafire se ai dhe sindikata që drejton do të vazhdojnë bashkëpunimin e sinqertë sindikal me sindikatat nga shtete të Ballkanit, Evropës dhe gjithë botës me qëllim që të vazhdohet solidariteti dhe mbështetja në gjithë përpjekjet për realizimin e objektivave sindikale dhe realizimit të kërkesave të anëtarësisë.



Vazhdon të realizohet agenda e Kuvendeve zgjedhore

Respekt dhe përkrahje për SBASHK-un kudo në Komunat e Kosovës

Krahas aktiviteteve tjera, stafi qendror ka shtuar mobilizimin me qëllim të realizimit të agjendës për Kuvendet zgjedhore sindikale nëpër komunat e Kosovës. Ky aktivitet ka qenë mjaft i dendur këtyre ditëve sepse janë mbajtur këto Kuvende në Prishtinë, Obliq, Gjilan, Kamenicë, Suharekë, Podujevë dhe Malishevë.



Kuvendin zgjedhor në Prishtinë e ka shpallur të hapur kryetari Ahmet Pllana, i cili ka falënderuar Qendrën e studentëve për mundësinë që ky aktivitet të zhvillohet në sallën e takimeve. Ai po ashtu ka shprehur gjithë respektin meritore për kryetarin Jasharaj, nënkryetaren Shala, koordinatoren Ymeri dhe stafin qendror, që ka

bërë e po bën vazhdimisht angazhime të jashtëzakonshme në shërbim të anëtarësisë. Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar pjesëmarrësit dhe ka shprehur respekt për angazhimet e shumta dhe kontributin e kolegut Pllana në rrjedhën e mbarë të aktivitetit sindikal në kryeqytet.



Pas leximit dhe aprovimit të raportit të punës dhe atij financiar është filluar me procesin zgjedhor. Për të pasur rrjedhë të mbarë procesi zgjedhor sqarime të duhura ka dhënë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Pjesëmarrësit e këtij Kuvendi me vota të fshehta i kanë shprehur besimin edhe për një mandat Ahmet Pllanës duke shprehur

kështu respektin për angazhimet e tij të dhe të kryesisë së kësaj komune. Janë zgjedhur edhe organet tjera të këtij Kuvendi , delegatët për Kongresin e SBASHK dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.



Kuvend zgjedhor po të enjten është mbajtur edhe në komunën e Obiliqit. Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë edhe nënkryetarja Vjollca Shala dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri. Ata kanë përshëndetur pjesëmarrësit dhe i kanë dëshiruar punë të mbarë këtij Kuvendi. Kryetarja e këtij Kuvendi Luljeta Boshnjaku ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar, që janë aprovuar nga të pranishmit . Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor. Përmes votës së fshehtë është rizgjedhur kryetare Luljeta Boshnjaku, ndërsa nënkryetar Selman Fazliu. Janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë, Komisioni mbikëqyrës dhe delegatet e Kongresit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues nga kjo komunë.



Edhe në Kamenicë është mbajtur Kuvendi zgjedhor, pjesë e të cilit ishin edhe kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Me votën e fshehtë Kuvendi ka zgjedhur kryetar Lulzim Thaçin, ndërsa nënkryetare Masure Morinën. Ky Kuvend po ashtu

përmes votës së fshehtë janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë, Komisioni mbikëqyrës, delegatët e Kongresit dhe përfaqësuesit në Këshillin Drejtues.

Kuvendi zgjedhor edhe në Gjilan e Suharekë

Në ambientet e shkollës “Selami Hallaqi” të dielën e 10 tetorit është mbajtur Kuvendi zgjedhor i sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Gjilanit. Edhe në këtë ngjarje sindikale kanë marrë pjesë kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj e koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Kryetari i këtij kuvendi Blerim Mehmeti ka falënderuar pjesëmarrësit e këtij takimi, që edhe pse është e diel, kanë ardhur për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të këtij takimi. Ai pastaj ka përshëndetur kryetarin Rahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke i përgëzuar për gjithë angazhimet dhe arritjet në shërbim të anëtarësisë. Në fjalën përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar koleget e kolegët nga kjo komunë për angazhimin në misionin e shenjtë të arsimit dhe edukimit të brezave dhe për unitetin e dëshmuar përballë shumë sfidave. Ai pastaj ka deklaruar se është krenar që ka punuar bashkë me Blerimin dhe koleget e kolegët tjerë në shërbim të anëtarësisë. Pas kësaj kryetari Mehmeti ka prezantuar Raportin e punës dhe atë financiar, që ishin punuar në mënyrë të qartë e të kujdesshme. Pjesëmarrësit kanë debatuar për këto dy raporte duke shprehur respekt për angazhimet dhe arritjet. “ Falë angazhimit, unitetit e përkushtimit të nivelit qendror , të kryetarit Jasharaj, stafit qendror, por edhe të kryetarit , kryesisë dhe gjithë anëtarësisë këtu janë shënuar arritje të shumta dhe janë shënuar arritje të shumta dhe është mbrojtur figura e mësuesit“, është shprehur përfaqësuesi i shkollës “Thimi Mitko”, Idriz Ramadani. Vlerësime të

tilla janë dëgjuar edhe nga pjesëmarrës të tjerë. Në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi është filluar me procesin e zgjedhjeve.

Me qëllim që ky proces të ketë rrjedhë të mbarë dhe të respektohet në tërësi Statuti, sqarime ka dhënë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri pastaj është filluar me propozimet për kryetar, nënkryetar, anëtarë të kryesisë, anëtarë të Komisionit mbikëqyrës, delegat për Kongresin dhe për përfaqësues nga Gjilani në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Pas përmbylljes së procesit të votimit pjesëmarrësit përmes votës së fshehtë kanë dëshmuar se vlerësojnë angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit Blerim Mehmetit dhe prandaj i kanë dhënë besimin edhe për një mandat, ndërsa nënkryetare është zgjedhur Ibadete Limoni. Po ashtu përmes votës së fshehtë janë zgjedhur edhe kryesia e këtij Kuvendi, Komisioni mbikëqyrës, delegatët nga kjo komunë për Kongresin e SBASHK-ut dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.



Kryetari Mehmeti ka falënderuar pjesëmarrësit për besimin dhe respektin dhe ka premtuar se do të vazhdojë bashkë me kryesinë angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Edhe në Suharekë është mbajtur Kuvendi zgjedhor, që është përcjellë me atmosferë pune e respekti për kryetarin Murat Bytyqi dhe për stafin qendror të SBASHK-ut. Para fillimit të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri të shoqëruar nga kryetari i sindikatës për Suharekën Murat Bytyqi dhe kryetar nderi Sadik Shala janë pritur nga drejtori i I Shkollës së mesme profesionale “Avdyll Rama”Destan Berisha. Drejtori Berisha ka shprehur respekt meritore për gjithë angazhimet, përkushtimin dhe arritjet e

SBASHK-ut e pastaj ka informuar mysafirët për rrjedhën e procesit mësimor në këtë institucion të dalluar arsimor. Ai ka vlerësuar lart angazhimin e gjithë personelit mësimor dhe të punësuarve tjerë këtu, të cilët me angazhime të vazhdueshme kanë bërë që të shënohen rezultate të mira në edukimin dhe arsimimin e brezave. Kryetari Jasharaj dhe mysafirët tjerë kanë përgëzuar drejtorin për angazhimin, përkushtimin dhe arritjet në realizimin e misionit të shenjtë në edukimin e arsimimin e brezave dhe për përkrahjen e vazhdueshme dhënë aktiviteteve të SBASHK-ut në këtë komunë.



Për të pasur rrjedhë të mbarë ky proces dhe me qëllim që të respektohet në tërësi Statuti i SBASHK-ut koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarimet e duhura. Në një garë mes dy e më shumë kandidatëve e me votë të fshehtë kryetar i ri i këtij Kuvendi është zgjedhur Nazmi Gashi, ndërsa nënkryetare Bahrije Elshani. Po ashtu janë zgjedhur edhe 7 anëtarë të kryesisë, Komisioni mbikëqyrës, delegatët për Kongres dhe përfaqësuesit e kësaj komune në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Duke vlerësuar lart angazhimin dhe kontributin në aktivitete sindikale Kuvendi ka shpallur kryetar nderi Murat Bytyqin, i cili tani më është pensionuar pas një pune të shkëlqyer me vite e dekada në edukimin e arsimimin e brezave.

Kuvend zgjedhor edhe në Podujevë

Në ambientet e shkollës “Ibrahim Rugova” të Podujevës u mbajt Kuvendi zgjedhor i sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Në hapje të punimeve të këtij Kuvendi kryetari Fadil Halimi ka



përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe nënkryetaren Vjollca Shala duke i falënderuar që janë pjesë e këtij aktiviteti me rëndësi. Kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur të pranishmit dhe ka shprehur respekt meritor për kolegun Halimi, kryesinë dhe veprimtarët tjerë sindikal nga kjo komunë, ndërsa nënkryetarja Vjollca Shala ka kujtuar çështje statutare që ndërlidhën me propozimet e kandidatëve për kryetar, nënkryetar, komision statutar, delegatë të Kongresit dhe përfaqësues në Këshillin Drejtues duke i vënë theks të veçantë në respektimin e barazisë gjinore dhe të kriterëve të tjera të përcaktuara qartë në Statutin e SBASHK-ut. Pas leximit e aprovimit të raportit të punës dhe atij financiar është kaluar në procesin e zgjedhjeve dhe në një garë mes dy e më shumë kandidatëve kryetar është rizgjedhur Fadil Halimi.



Pas kësaj Kuvendi ka vazhduar punimet me procesin zgjedhor. Përmes votës së fshehtë anëtarët e këtij Kuvendi kanë dëshmuar se vazhdojnë me besimin dhe mbështetjen për Fadil Halimin duke e zgjedhur edhe për një mandat. Po ashtu me votë të fshehtë nënkryetare është zgjedhur Lumnije Tahiri. Procesi i kandidimeve dhe votimit të fshehtë ka vazhduar dhe janë zgjedhur pesë anëtarë të kryesisë, Komisioni mbikëqyrës, delegatët nga kjo komunë për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit në Këshillin Drejtues.

U vlerësuan lart arritjet e SBASHK-ut dhe përkushtimi i kryetarit Skënder Gashi

Në ambientet e Gjimnazit “Hamdi Berisha” është mbajtur Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Malishevës. Respektin për arritjet dhe angazhimet e SBASHK-ut në nivelin qendror dhe atë komunal koleget e kolegët tanë nga kjo komunë e kanë dëshmuar me pjesëmarrjen dhe me debatet konstruktive duke kthyer kujtesën në momente të veçanta të angazhimeve që kanë dëshmuar përkushtimin dhe unitetin e sindikatës sonë në Malishevë dhe kudo në Kosovë.



Në hapje të këtij takimi zgjedhor kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Malishevës, Skënder Gashi ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe pastaj ka falënderuar kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri, që janë pjesë e këtij takimi të veçantë për sindikalistët e arsimit të kësaj komune. Pas kësaj Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar koleget e kolegët e pranishëm për besimin që kanë marrë në shoqatat e tyre sindikale dhe për gjithë angazhimet në shërbim të arsimit në kushte të vështirësuar nga pandemia. Kryetari Jasharaj ka shtuar se gjithë arritjet tona janë fryt i angazhimeve të përbashkëta dhe unitetit të krijuar që është rezultat i punës e përkushtimit maksimal të stafit qendror, të Skënder Gashit, po edhe të kryetarë e të tjerë nëpër komunat e Kosovës dhe në Universitete.

Pas kësaj kryetari i këtij Kuvendi Skënder Gashi ka prezantuar raportin e punës nga maji i vitit 2019, kur ishte zgjedhur kryetar, pas pensionimit kryetarit të nderuar Elez Krasniqi. Në debatin lidhur me raportin e prezantuar të punës ka pasur diskutime

përmbytjesore. Kështu veprimtari sindikal Haxhi Berisha ka vlerësuar se raporti ka përfshirë vetëm disa nga aktivitetet dhe arritjet dhe se anëtarësia në Malishevë kudo vlerëson lart angazhimet e SBASHK-ut në nivel të komunës dhe në nivelin qendror dhe i është mirënjohës stafit të SBASHK-ut .



Kryetari i këtij Kuvendi pas kësaj ka prezantuar edhe raportin financiar nga maji i vitit 2019 deri në tetorin e vitit 2021, i cili është aprovuar nga Kuvendi. Pas kësaj është kaluar në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi . Komisioni zgjedhor ka nisur të kryej obligimin e tij, i ndihmuar nga këshillat profesionale

të zyrtarit ligjor të SBASHK-ut Blendor Shatri, i cili ka kontribuar që të tejkalohen dilemat eventuale lidhur me kërkesat e Statutit në respektim të barazisë gjinore.

Me votën e lirë e të fshehtë ky Kuvend ka treguar për respektin ndaj angazhimit e përkushtimit të kolegut Skënder Gashi duke e rizgjedhur edhe për një mandat në cilësinë e kryetarit të këtij Kuvendi, ndërsa po me votën e fshehtë e të lirë nënkryetare është zgjedhur Labearta Selimi. Komisioni zgjedhor duke lexuar publikisht rezultatet e votimit ka treguar edhe emrat e anëtarëve të kryesisë, delegatëve për Kongresin e SBASHK-ut dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues nga kjo komunë.

Do theksuar se si në Podujevë ashtu edhe në Kuvendet zgjedhore të mbajtura në komunat tjera pjesëmarrësit duke shprehur respekt për angazhimet e kryetarit Rrahman Jasharaj dhe gjithë stafit qendror kanë dalë me përkrahjen dhe propozimin mbështetës për Jasharajn që të zgjidhet edhe për një mandat kryetar i SBASHK-ut.

ETUCE vazhdon takimet me sindikatat anëtare

Në përballje me sfidat e shumta të kohës

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me sindikatat anëtare që përfaqësojnë 11 milionë punëtorë të arsimit nga gjithë shtetet e Evropës. Njëri nga aktivitetet me rëndësi të veçantë i ETUCE-s ishte edhe Konferenca përmbyllëse e organizuar në shtëpinë e sindikatave në Bruksel. Si edhe herave tjera, edhe në këtë ngjarje të veçantë për arsimin e Evropës mori pjesë edhe SBASHK-u përfaqësuar nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Në hapje të Konferencës mirëseardhje në Bruksel u kanë dëshiruar delegacione sindikale kryetari i ETUCE-s , Larry Flanagan dhe drejtorja e përgjithshme Suzan Flocken. Ata pastaj i kanë dhënë theks të veçantë vështirësive të shumta dhe sfidave që ka krijuar pandemia sektorin e arsimit, por edhe në sferat tjera dhe në vetë jetën e njeriut. Pas kësaj pjesëmarrësit kontributin e tyre në rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti e kanë dhënë duke u ndarë në grupe punuese duke punuar me përkushtim në përgatitjen e strategjisë konkrete për zbatimin e planit konkret të veprimit të ETUCE-s. Angazhim i gjithë pjesëmarrësve ka qenë dhënia e përgjigjes adekuate për gjithë-përfshirjen dhe aktivitetet e suksesshme arsimore e sindikale për kërkuar që qeveritë duhet siguruar financim të qëndrueshëm publik, ambient të sigurt pune dhe pagë e mirë dhe dialog të mirëfilltë social mes sindikatave dhe institucioneve në nivelin lokal e qendror.



Vlerësim i përbashkët i pjesëmarrësve ishte se në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme të Evropës është jetike të sigurohet barazi dhe përfshirje në arsim. Nevoja për të përqaftuar diversitetin në arsim po merr gjithnjë e më shumë vëmendje politike në nivel

Bashkëpunim i shkëlqyer me sindikatat tjera

SBASHK-u solidarizohet me Sindikatën e Policisë së Kosovës

SBASHK-u ka bashkëpunim të shkëlqyer me Sindikatën e Policisë së Kosovës dhe gjithmonë u është gëzuar arritjeve dhe është ndjerë krenar me veprimet heroike të shumë pjesëtarëve të policisë sonë.



Në kuadër të këtij bashkëpunimi SBASHK-u u solidarizua me Sindikatën e Policisë duke dënuar ashpër sulmin e fundit ndaj pjesëtarëve të policisë sonë në veri të vendit.

SBASHK thekson se Policia e Kosovës gëzon respektin merit të mijëra punëtorëve të arsimit, të cilët flasin me krenari për djemtë e vashat, që dikur ishin nxënës të tonë e tani qëndrojnë krenar në krye të detyrave duke ruajtur buzëqeshjen e fëmijëve dhe jetën tonë përmes angazhimeve e sakrificave sublime në përballje me ata që nuk e duan dritën, po janë shërbëtorë të errësirës.

U mbajt takimi konstituiv i Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së Mobilizim për realizimin e detyrave konkrete



Pas zgjedhjes përmes votës së fshehtë nga delegatët e Kongresit të BSPK-së, kryetari i ri i kësaj Konfederate prof. dr. At dhe Hykolli ka ftuar mbledhjen e Kryesisë Ekzekutive për të bërë konstatimin e këtij organi të rëndësishëm sindikal dhe për të bashkëbiseduar për detyrat konkrete, që do të jenë në shërbim të shtimit të angazhimeve e mobilizimit në shërbim të anëtarësisë së të gjitha Federatave përbërëse të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Kryetari Hykolli në hapje të këtij takimi edhe një herë ka falënderuar përfaqësuesit e Federatave në Kryesinë Ekzekutive për mbështetjen dhe besimin e dhënë duke premtuar se bashkë me ta do të angazhohen për

realizimin e detyrave konkrete dhe kërkesave legjitime të gjithë anëtarësisë. Ai ka kërkuar mbështetjen e anëtarëve të këtij organi ekzekutiv, por edhe të gjithë anëtarësisë nga Federatat përbërëse të BSPK-së me qëllim që të forcohet zëri sindikal në Kosovë dhe të bëhen përpjekje maksimale për realizimin e objektivave që janë bërë publike në Kongresin e BSPK-së.

Pas një debati të hapur e përmbajtjesor Kryesia Ekzekutive me qëllim të konstituimit edhe të organeve tjera ka vendosur që të mbahet më 20 nëntor takimi i Këshillit Drejtues të BSPK-së për të marr vendime brenda kompetencave që ka.

